



KONVENTA MBI  
**TË DREJTAT  
E FËMIJËS**



Për fëmijët, nga fëmijët

## **Konventa për të Drejtat e Fëmijës**

Për fëmijët, nga fëmijët

Botim i "Save the Children", Programi për Shqipërinë

Tiranë 2002

Adresa: Rruga "Komuna e Parisit", Pallatet 1 Maji, Vila "Lartu"; P.O.Box 8185 Tërana - Albania Tel: 00355 4 261840 / 261929 / 266227

Fax: 00355 4 263 428 E-mail: [savalbania@savealbania.org](mailto:savalbania@savealbania.org) Web page: [www.savealbania.org](http://www.savealbania.org)

---

© Të gjitha të drejtat janë të "Save the Children", Programi për Shqipërinë

---

E drejta e ribotimit të pjesëve të shkëputura ose të gjitha kënj libri i jepet kujtdo që do të dëshirojë ta bëjë një gjë të tillë, me kusht që riprodhimi i pjesëshëm ose i gjithë librit të bëhet duke ruajtur qëllimet për të cilat u botua libri ose kontekstin e pjesëve të veçanta të tij. E drejta e autorësisë së librit i njihet fëmijëve pjesëmarrës në këtë projekt si një grup i vetëm. Ndryshime të mundshme në ribotime të mëvonëshme nuk mund të bëhen pa lejen paraprake me shkrim të të gjithë fëmijëve pjesëmarrës në projekt si edhe të fondacionit "Save the Children". Përkthimi i librit në fjalë mund të bëhet nga çdo përkthyes i licensuar për përkthime, me kusht që versioni përfundimtar i përkthimit të konsultohet me fondacionin "Save the Children", që do të sigurohet për përpikërinë e terminologjisë në procesin e përkthimit.

Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi

Korrektor letrar: Arjana Mero

Ilustrimet: Kosta Raka

Fotografia: "Save the Children", Programi për Shqipërinë

Konventa për të drejtat e fëmijës: për fëmijët - nga fëmijët. -

Tiranë : Save the Children, 2002

87 f: me il. 59; 20 cm.

ISBN 99927-785-0-1

342.7-053.2(094.2)

# KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

---

Për fëmijët, nga fëmijët



## Mirënjohje!!

**N**ë këtë hapësirë do të dëshironim të falenderonim të gjithë ata individë dhe institucione që kanë dhënë një ndihmë të vyer në ideimin si dhe në punën përgatitore të këtij libri. Falenderime të veçanta për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe Drejtorinë Arsimore në Elbasan, që bënë të mundur zbatimin e këtij projekti në shkollën “Haxhire Myzyri 2” sot “Fejzullah Guranjaku” Elbasan. Falenderime për drejtoritë dhe mësuesit e shkollave “Jeronim De Rada”, “Jorgji Dilo”, Haxhire Myzyri Nr1”, “Qamil Guranjaku”, “Bardhyl Popa”, “Ptoleme Xhuvani”, “Sulë Misiri”, “Ali Agjahu”, “Abdyl Myzyri”, “Dhaskal Thodhri”, Elbasan të cilat ndihmuan në procesin e përzgjedhjes së grupit të fëmijëve që rishikuan këtë libër. Gjithashtu e falenderojmë këtë drejtori dhe drejtoritë e shkollave 8- vjeçare Shushicë, Gjegjan dhe Kuqan për ndihmën që na dhanë për diskutimin me nxënësit e tyre në lidhje me nenet e rishikuara.

Për kontributin e tyre në diskutimin e neneve falenderojmë gjithashtu Drejtorinë Arsimore të Dibrës dhe Durrësit, në veçanti drejtoritë e shkollave “Demir Gashi”, “Selim Alliu”, “Irfan Hajrullai” dhe gjimnazin Dibër; drejtoritë e shkollave “Marije Kaçulini”, “Eftali Koçi” Durrës dhe “Muharrem Dollaku” (Shijak).


Mirënjohje të veçantë të gjithë atyre fëmijëve dhe të rinjve të shkollave të sipërpërmendura për ndihmën që dhanë me sugjerimet e tyre, për rishikimin sa më të qartë të neneve.

Falenderim i veçantë për prindërit e fëmijëve autorë të këtij libri, të cilët na mirëkuptuan, mbështetën dhe lehtësuan pjesëmarrjen e fëmijëve në këtë proces.

Nuk mund të lemë pa falenderuar Muzeun Kombëtar, Qendrën Rinore “Delfi XS”, UNICEF në Shqipëri dhe në veçanti Z.Roberto Laurenti dhe Benjamin Perks për pritjen dhe organizimin e vizitës së fëmijëve në këto zyra. Gjithë stafin e Qendrës për Zhvillimin e Fëmijës në Tiranë dhe në veçanti zj.Elida Cangonji, zj.Olta Çakçiri, z.Garion Kalaçi, z.Florian Ballhysa nga CRMS, zj.Rezarta Shashai për kontributin e tyre pa pagesë për rishikimin e neneve dhe përgjegjësitë të këtij libri.

Mirënjohje të veçantë zj.Shpresa Vreto për ndihmën e saj të paçmueshme.

Falenderime për zj.Ariana Mero për korrektimin letrar falas që i bëri tekstit të përkthyer nga fëmijët.



### **Për të gjithë fëmijët që lexojnë këtë libër:**

Në faqen nr.88 do të gjeni një test me anë të të cilit mund të provoni se sa i keni kuptuar të drejtat tuaja. Nëse keni gjetur përgjigjet përpara fundit të dhjetorit 2002 mund të na i postoni ato dhe do të jeni fitues të çmimeve që organizata “Save the Children” vë në dispozicion të fëmijëve që do të japin përgjigje të sakta. Fituesit do të përcaktohen nga një juri fëmijësh.

#### **Mund të na dërgoni letrat në:**

Save the Children  
Kutia Postare 8185  
Tiranë



## **Dy fjalë** **Të dashur bashkëmoshatarë!** **nga autorët**

Në vitin 1989 është shkruar një dokument që flet për të drejtat e fëmijës me titull “Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës”. Këtë dokument, ne, një grup fëmijësh nga Elbasani e kemi kthyer në libër, në një gjuhë më të thjeshtë, për ne fëmijët. E kemi bërë këtë punë, në mënyrë që edhe fëmijët e vegjël të mund ta kuptojnë. Pse do të thoni ju ? Sepse Konventa ishte shkruar me fjalë të mëdhaja. Me fjalë që nuk kuptoheshin. Këto fjalë ne i zbërthyem dhe tani kjo Konventë që është në duart tuaja është shkruar në gjuhën e fëmijëve. Shkruarjen e kemi bërë kështu: ndaheshim në grupe dhe jepnim mendime të ndryshme dhe në fund arrinim në një mendim të përbashkët. Të gjithë këtë punë e kemi bërë të ndihmuar nga specialistë të kësaj fushe.

Të gjithë ju fëmijë që merrni në dorë këtë libër duhet të dini se në këtë libër nuk janë vetëm të drejtat tuaja por edhe detyrat.

Kur të merrni në dorë këtë libër dhe të lexoni të drejtat tuaja, do t’i kuptoni më shumë ato. Po ç’janë të drejtat e fëmijëve? Këto janë disa gjëra që ju duhet t’i keni patjetër për të pasur një jetë më të mirë. Në ju urojmë të merrni dhe të mos shpërdoroni Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Në fund do të donim t’ju jepnim një mesazh:

Kërkoni respektimin e të drejtave tuaja dhe jeta juaj do të jetë më e lumtur.  
Zbatoni detyrat tuaja dhe për të gjithë do të jeni fëmijët më të mirë në botë.


**Autorët e librit**



## Hyrje

1. Çdo njeri në botë ka të drejtat e tij. Gjërat më të rëndësishme në botë janë: Liria, Drejtësia dhe Paqja. Këto arrihen duke respektuar të drejtat e të gjithë njerëzve.
2. Pothuajse çdo shtet në botë është anëtar i Kombeve të Bashkuara (këty hyn edhe Shqipëria). Këto shtete besojnë se çdo njeri ka rëndësinë e vet në shoqëri dhe të drejtat e tij. Shtetet duhet të përpiqen që njerëzit të kenë një jetë sa më të mirë.
3. Të gjithë njerëzit në botë janë të ndryshëm nga raca, gjinia, feja, mendimet politike etj. Të gjithë ata kanë të drejta të barabarta.
4. Njerëzit nën 18 vjeç kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të veçantë.
5. Familja është vendi më i mirë ku mund të rritet fëmija. Familja duhet të ndihmohet dhe të mbrohet nga shteti që ta edukojë fëmijën sa më mirë.
6. Që të rritet sa më mirë, familja duhet t'i sigurojë atij dashuri, ngrohtësi dhe mirëkuptim.
7. Fëmija duhet të përgatitet për të përballuar jetën në shoqëri. Dhe për këtë ai duhet të mësojë të jetë tolerant, të jetojë në paqe, në liri dhe të sillet me të tjerët në mënyrë të barabartë.
8. Kombet e Bashkuara kanë shkruar shumë deklarata. Shumë nga këto deklarata bëjnë të mundur që fëmijëve t'u sigurohet kujdesi dhe mbrojtja e duhur.
9. Në Deklaratën për të Drejtat e Fëmijëve thuhet se "Fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale, ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu edhe pas lindjes".
10. Ka edhe shume marrëveshje të tjera në ndihmë të fëmijëve. Ato flasin për birësimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit, vendosjen e





fëmijës në një familje tjetër që e ushqen dhe që fëmija të ketë kushte të përshtatshme për të jetuar. Gjithashtu, ato flasin që të ketë ligje e gjykata të veçanta për fëmijët dhe gratë e fëmijët të mbrohen nga lufta.

11. Në botë ka fëmijë që jetojnë shumë keq. Për ta duhet të ketë një kujdes të veçantë.

12. Çdo fëmijë ka zakonet dhe traditat e vendit të vet. Ai duhet të rritet duke i mësuar ato.

13. Shtetet punojnë me njëri-tjetrin që fëmijët të jetojnë më mirë. Ata ndihmojnë më tepër vendet e varfëra.

14. Vendet që pranojnë dhe zbatojnë këtë Konventë, duke u nisur nga gjërat e thëna më sipër, ranë dakort për 54 nenet e mëposhtëme.








## Përkufizimi i fëmijës

Fëmijë quhet çdo njeri që nuk ka mbushur moshën e rritur, e cila është 18 vjeç. Në raste të veçanta moshë e rritur fillon më shpejt. Këto raste varen nga ligjet e shtetit të tij.





## Neni 2

Kjo shkollë nuk është për fëmijët me paaftësi fizike



## E drejta për barazi dhe mosdiskriminim

1. Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta pa dallim. Shtetet kanë për detyrë të zbatojnë dhe t'ua sigurojnë këto të drejta, pa dallim, çdo fëmije që jeton në këto vende. Sigurimi i këtyre të drejtave nuk varet nga raca, pamja e jashtme, ngjyra e lëkurës. Nuk varet nëse je vajzë ose djalë. As nga gjuha që flet, besimi fetar ose mendimet e ndryshme. Nuk varet as nga vendi ku ke lindur dhe zakonet e tij. Nuk ka rëndësi nëse fëmija është i pasur ose i varfër, nëse është me paaftësi mendore dhe fizike apo jo dhe as nëse është i njohur ose jo.

2. Fëmija i gëzon këto të drejta edhe kur nuk i ka prindërit e vërtetë.

3. Shteti duhet të bëjë çdo gjë që fëmija të mbrohet me të vërtetë. Ai duhet të mbrohet nga të gjitha mënyrat e dallimit për të keq ose



keqtrajtimet. Kjo është njëloj për të gjithë fëmijët; edhe kur roli, puna, mendimet e thëna ose bindjet e prindërve, ose kujdestarëve të tij janë të ndryshme nga mendimet e të tjerëve.

\* Fshi, kur shkollat janë të ndara: njerëzit me ngjyrë veç, të bardhë veç, kur nuk krijohen shkolle për fëmijët me paafësi mendore dhe fizike, që të jenë bashkë me fëmijët e tjerë, etj.




## Detyrat e Nenit 2

1. Fëmijët duhet të sillen njëloj me fëmijët e tjerë edhe kur raca, pamja e jashtme, ngjyra e lëkurës janë të ndryshme.
2. Fëmijët nuk duhet të bëjnë dallime për shokët apo shoqet që kanë paafësi mendore dhe fizike.
3. Fëmijët duhet të ndihmojnë fëmijët që janë më të varfër dhe të mos i tallin.
4. Fëmijët duhet të sillen njëloj si me djemtë edhe me vajzat.
5. Fëmijët duhet të respektojnë fenë e mendimet e të tjerëve.
6. Fëmijët nuk duhet të fyejnë vendin dhe zakonet e vendit të një fëmije tjetër.
7. Fëmija nuk duhet të kundërshtojë më fjalë fytyrë shokun, kur ka një mendim të ndryshëm nga ai i tij.
8. Fëmijët kanë për detyrë të mos tallin e keqtrajtojnë shokun e tyre, për shkak të ndryshimit të ngjyrës së lëkurës.
9. Fëmijët duhet t'i ndihmojnë dhe të trinë me fëmijët me paafësi mendore e fizike.



## Neni 3



## Interesi më i lartë i fëmijës

1. Çdo vendim që merr shteti, një grup njerëzish ose njerëz të veçantë për fëmijën, duhet të jetë gjithmonë në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Shteti bën çdo gjë që mundet që fëmija të rritet sa më mirë. Gjithashtu, shteti pranon të drejtat dhe detyrat e prindërve ose të njerëzve që me ligj kujdesen për fëmijën.

3. Shteti duhet të bëjë gjithçka që institucionet\*, të cilat kujdesen dhe mbrojnë fëmijët, të zbatojnë ligjet dhe rregullat e shtetit.

\* Institucion - Ndërtesë ku punojnë shumë njerëz për të ndihmuar fëmijët. Mund të jetë shtetërore ose jashtetërore. Psh., kopshti, shkolla etj.

Interesi më i lartë i fëmijës.



Elisa Kotherja

### Detyrat e Nenit 3

1. Fëmijët duhet të zbatojnë vendimet që merr shteti ose një grup njerëzish të veçantë për ta.
2. Fëmijët duhet të pranojnë ndihmën që u jepet për të mirën e tyre.
3. Fëmijët duhet t'i binden punonjësve të institucioneve që kujdesen për ta.
4. Fëmijët duhet t'u kërkojnë ndihmë institucioneve që kanë për detyrë t'i mbrojnë ata.

## Neni 4

Tani që Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës u ratifikua, duhet të përshtasim ligjet sipas neneve të saj.

Do të shkoj nesër të bisedoj me kryetarin e kuvendit për këtë.



Duhet të ngrihet një grup pune në mënyrë që të përshtasë ligjet me Konventën.




Ligji mbi birësimin duhet të ndryshojë. Duhet të bëhet si në Konventë.

## Përgjegjësia e shtetit për të drejtat e fëmijës

Shtetet duhet të përshtasin nenet e ligjeve të tyre me ato të Konventës. Këto shtete duhet të krijojnë institucione, që ndihmojnë zbatimin e këtyre neneve. Shtetet duhet të bëjnë gjithçka që të zbatojnë të gjitha të drejtat e shkruara në Konventë. Kur nuk kanë mundësi, ata kërkojnë ndihmën e shteteve të tjera.






Blerina Maloku

## Detyrat e Nenit 4

1. Fëmijët duhet të ndihmojnë në krijimin e mjeteve, që bëjnë të mundur zbatimin e Konventës.
2. Fëmijët duhet të zbatojnë të drejtat dhe detyrat e shkruara në Konventë.
3. Fëmijët nuk duhet t'i përdorin keq mjetet që ndihmojnë në zbatimin e neneve.
4. Fëmijët nuk duhet të kundërshtojnë zbatimin e neneve.
5. Fëmijët duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin, nëse kanë mundësi, në rast nevojë.





## Udhëheqja prindërore dhe zhvillimi i aftësive të fëmijës

Shteti duhet të respektojë të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ndaj fëmijës. Kjo qëndron edhe për njerëzit që me ligj kujdesen për fëmijën. Ata duhet t'i mësojnë fëmijës të zbatojë të gjitha të drejtat dhe detyrat e tij të shkruara në Konventë. Kjo bëhet sipas moshës dhe mundësive të fëmijës.



Le kemi të drejta.

Respektojimi të drejtat tona që  
me të zbatjme detyrat tona  
ndaj jush.

## Neni 6




### E drejta për mbijetesë dhe zhvillim

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetojë. Çdo shtet duhet të sigurojë që fëmija të jetojë dhe të zhvillohet\*.

\* Zhvillim - Rritje mendore dhe trupore.






Mos vrisni njeri - fjetim

Artemisa Cane

## Detyrat e Nenit 6

1. Fëmijët nuk duhet të vrasin asnjë njeri.
2. Fëmijët nuk duhet të përdorin keq mjetet shkollore, veshjet dhe mjediset e lojrave.



## Neni 7



## E drejta për të pasur emër dhe shtetësi

Çdo fëmijë, sapo lind, duhet të regjistrohet dhe të ketë një emër. Gjithashtu, ai ka të drejtë të ketë një shtetësi. Fëmija që nuk jeton me prindërit e tij ka të drejtë t'i njohë ata dhe, nëse është e mundur, të ketë kujdesin e tyre. Këto të drejta duhet të zbatohen sipas ligjeve të vendit të fëmijës. Ka edhe institucione të tjera, si p.sh., policia, gjykata etj., që e detyrojnë shtetin të zbatojë këto të drejta. Kjo bëhet që fëmija të mos mbetet pa shtetësi, sepse i humbet të gjitha të drejtat.

\* Të njohet ligërisht si pjesëtar i këtij shteti.



## Neni 7



## E drejta për të pasur emër dhe shtetësi

Çdo fëmijë, sapo lind, duhet të regjistrohet dhe të ketë një emër. Gjithashtu, ai ka të drejtë të ketë një shtetësi\*. Fëmija që nuk jeton me prindërit e tij ka të drejtë t'i njohë ata dhe, nëse është e mundur, të ketë kujdesin e tyre. Këto të drejta duhet të zbatohen sipas ligjeve të vendit të fëmijës. Ka edhe institucione të tjera, si p.sh., policia, gjykata etj., që e detyrojnë shtetin të zbatojë këto të drejta. Kjo bëhet që fëmija të mos mbetet pa shtetësi, sepse i humbet të gjitha të drejtat.

\* Të njohet ligjërisht si pjesëtar i këtij shteti.





## E drejta për të ruajtur identitetin

Fëmija ka të drejtë të ketë identitetin e tij. Identiteti ka të bëjë me emrin, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, shtetësinë etj. Shtetet mbrojnë me ligj identitetin e fëmijës. Ka disa raste kur fëmijës i hiqet emri, mbiemri ose i gjithë identiteti. Shteti ka për detyrë ta ndihmojë atë sa më shpejt.

### Detyrat e Nenit 8

1. Fëmijët duhet të ndihmojnë, nëse kanë mundësi, për të gjetur identitetin e një fëmije tjetër.

Unë jam Arditi. Nuk e mbaj mend mbiemrin. Di vetëm që kam mamën dhe babin tim.



A e njihni këtë fëmijë?

Duhet t'i gjejmë sa më shpejt prindërit e këtij fëmije.



Ju lutemi të gjithë teleshikuesve që njohin këtë fëmijë të na njoftojnë se ku mund të gjejmë familjen e tij.



Po xhaxhi, unë e njoh mamën e Ardilit, ata banojnë në një pallat me mua.







## E drejta për të jetuar me të dy prindërit

1. Fëmija ka të drejtë të jetojë me prindërit e tij. Fëmija mund të jetojë edhe vetëm me njërin nga prindërit, kur ata ndahen. Kur prindërit sillen keq me fëmijën, shteti duhet t'ua marrë atë. Kjo bëhet për interesin më të lartë të fëmijës.

2. Për rastet e thëna më sipër, prindërit, fëmija dhe njerëzit e tjerë, që me ligj kujdesen për të, duhet të marrin pjesë në diskutimet që bëhen për fëmijën. Ata duhet të thonë mendimet e tyre.

3. Çdo fëmijë i ndarë nga njëri ose të dy prindërit ka të drejtë të shohë, të takojë dhe të rrijë një kohë të caktuar me prindërit e tij. Kjo gjë ndalohet kur i bën keq fëmijës.



4. Shteti mund ta ndajë fëmijën nga prindi. Kjo bëhet kur prindi arrestohet, burgoset, largohet me forcë nga vendi ose dënohet me vdekje. Shteti duhet t'i tregojë fëmijës se ku ndodhet pjesëtari i tij i familjes. Shteti nuk mund t'i tregojë këtë vend fëmijës, nëse i bën keq atij. Shteti nuk duhet të dënojë as fëmijën që kërkon të dhëna dhe as pjesëtarin e familjes që kërkohet.

## Detyrat e Nenit 9

1. Fëmijët duhet të kërkojnë ndihmë, që të jetojnë me prindërit.
2. Fëmijët duhet të ndihmojnë fëmijët e ndarë nga prindërit.
3. Fëmijët duhet ta thonë mendimin e tyre, kur merren vendime për ta.



4. Fëmijët duhet të takojnë prindërit kur kanë mundësi, nëse ata janë të ndarë.
5. Fëmijët duhet t'i kërkojnë prindërit, kur ata janë të ndarë.
6. Fëmijët duhet ta bëjnë këtë, duke mos i bërë keq vetes dhe të tjerëve.





## E drejta për një familje të ribashkuar

1. Shteti bën gjithçka që duhet që fëmijët dhe prindërit të bashkohen sa më shpejt. Shtetet nuk duhet të dënojnë as ata që bëjnë kërkesën për t'u bashkuar me familjen, as pjesëtarët e tjerë të familjes.

2. Fëmijët kanë të drejtë të rrinë për një kohë të caktuar me njërin ose të dy prindërit, kur ata banojnë në shtete të ndryshme. Gjithashtu, ata kanë të drejtën të kthehen në vendin e tyre.



*E mërcitux unë jam  
në kulm të fëmijërisë  
këtu në një shtëpi  
në mes të Italisë.  
Më ka marrë malli  
për të gjithë,  
për babin, për shokët  
për njerëzit e shtëpisë.  
Nuk di ç' të bëj  
nuk di ku të shkoj.  
Mami më thotë  
se ka nevojë të punojë.  
Çdo ditë që kalon  
mërcitjet më shtohen  
dhe unë varkdoj të dobëshem.  
Mami gjithë ditën  
punon në punë*

*e shoh vetëm në mbremje  
kur fle gjumë.  
Një ditë të diel  
dikush trokiti në dorë  
dhe i xoti i shtëpisë  
e hapi si përherë.  
Përpara u shfaq babi im  
shkova me vrap dhe i dhashë një përqaftim.  
Më vonë një gjyq u hap  
mami kishte inat.  
Unë të dy i doja  
po më shumë  
me babin doja të qëndroja.  
Gjyqi mbaroi  
vendimi u mor.  
Mamaja do të vinte  
me ne në Shqipëri  
dhe do të jetonim  
bashkë përsëri.*

*Rudina Hooha*

## Detyrat e Nenit 10

1. Fëmijët duhet t'i rrinë pranë fëmijëve që janë të ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit.
2. Fëmijët duhet të bashkohen me prindërit, kudo qofshin ata.
3. Fëmijët duhet të shkojnë rregullisht në takimet që bëjnë me prindërit, kur ata jetojnë larg njëri-tjetrit.
4. Fëmijët duhet t'u binden vendimeve që merr familja, me qëllim që ajo të bashkohet përsëri.

*I dashur Ditari,*


*Tani që po flas me ty jam në anijen "Euta". Por të shkruaj pas 6 muajsh dhe më ka marrë malli. Po të shkruaj se... se si jam. Kur mami dhe babi u ndanë, unë thashë se ajo ishte dita më e keqe e jetës time. Po nuk ishte e vërtetë. Mami im jetonte në Itali dhe ajo më mori të rija ca ditë atje me të. Mirëpo kaluan muaj e muaj he nuk më ktheu te babi. As zërin nuk ia dëgjoja babit më, dhe më dukej sikur kishte udekur. Mami më thoshte që ata të dy kishin rënë dakort që unë të rija në Itali me mamën. Phhhh, po pse s' më telefonoi asnjëherë mua zhanëm?! Mami më bleu biçikletë dhe më futi në një shkollë të bukur. Po mua më kishte marrë malli për shokët e mi, lagjen dhe sidomos për babin. Unë doja të flisja me babin në telefon, por mami nuk më linte. Një ditë unë mbledha lekët dhe bleva një kartë dhe telefonova babin. Ata minuta të folëm bashkë, nuk kemi pushuar së qari. Unë e pyeta babin që ç' kishte që s' donte të fliste me mua. Babi më sqaroi se ai më donte shumë dhe se po më priste. Ai nuk kishte rënë dakort me mamën për asgjë. Më tregoi se si mua mami më kishte mbajtur jashtë rregullave dhe ligjeve. Unë i thashë se e doja mamën dhe e kisha inat se ajo më mbante pa dëshirën time larg tij. Pastaj babi foli me ca xhaxha e teta avokate edhe në Itali edhe në Shqipëri, dhe tani, ditari i dashur, unë po kthehem në vendin tim. Po kthehem aty ku unë dua dhe ku nuk më mbajnë me forcë. Vetëm se... se si jam. Pse mami të më mbante fshehtë? Nuk e di. Ndoshta nuk jam aq i zgjuar që t' i kuptoj gjithë këto gjëra. Po një gjë e di me siguri, unë dua të mos më gënjëjnë dhe të mos më mbajnë me forcë.*




## E drejta për të mos u zhvendosur në mënyrë të paligjshme (as nga prindërit)

1. Ka fëmijë që mbahen me forcë jashtë vendit të tyre. Shtetet duhet të bëjnë gjithçka për të kthyer fëmijën në vendin e tij.
2. Për këtë gjë shtetet mundohen të bëjnë sa më shpejt marrëveshje të reja dhe të zbatojnë marrëveshjet që janë. Këto marrëveshje mund të bëhen mes dy a më shumë shteteve.







Fëmija është aq i rritur sa të vendosë vetë për atë që do, ai duhet të vijë të thotë se me cilin prind do rrijë.

## E drejta për të shprehur mendimin në çështjet që lidhen me fëmijën


1. Fëmija ka të drejtë të thotë lirish mendimin e tij. Shteti ua siguron këtë të drejtë të gjithë fëmijëve që mund të kenë mendime.
2. Kjo bëhet që fëmija të dëgjohet në çdo vend ku merren vendime për të, në gjyq ose diku tjetër. Mund të ndodhë që fëmija nuk mund të jetë atje. Atëherë mendimin e tij mund ta shprehë një njeri që me ligj kujdeset për të, kur fëmija nuk ka prindër.





## Detyrat e Nenit 12

1. Fëmijët duhet të shprehin mendimin lirisht, por duke respektuar të tjerët.
2. Fëmijët që mund të kenë mendimet e tyre, duhet t'i shprehin ato kur diskutohet për ta në gjyq ose diku tjetër.
3. Fëmijët duhet të thonë gjithmonë të vërtetën.
4. Fëmijët duhet të zbatojnë rregullat në çdo veprim gjyqësor ose veprim tjetër që lidhet me ta.




## E drejta e shprehjes në të gjitha mënyrat

1. Fëmija ka të drejtë të thotë mendimin e tij me fjalë, shkrim, vizatim, vjersha, skeçe të ndryshme etj. Kjo do të thotë që fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të japë lajme e mendime të ndryshme.

2. Ndodh që kjo e drejtë të ndalohe. Kjo ndalohe që të respektohen të drejtat dhe liritë e njerëzve.







## Detyrat e Nenit 13

1. Të gjithë fëmijët duhet të dëgjojnë mendimin e tjetrit deri në fund.
2. Të gjithë fëmijët duhet të shprehin mendimin e tyre dhe pa fjalë fyese.
3. Asnjë fëmijë nuk duhet të thotë gjëra që dëmtojnë të tjerët.





## E drejta e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

1. Fëmija ka të drejtë të ketë mendimin e tij. Ai, në të njëjtën kohë, është i lirë të zgjedhë fenë ose të ketë ndërgjegjen\* e vet.
2. Prindërit dhe njerëzit që me ligj kujdesen për të, duhet t'i mësojnë fëmijës të drejtat e tij.
3. Ndodh që kjo e drejtë të ndalohej. Kjo bëhet që të respektohen të drejtat dhe liritë e njerëzve.


\* Ndërgjegje - Zëri i brendshëm që të thotë se çfarë është e drejtë ose e gabuar, e mirë ose e keqe.



## Detyrat e Nenit 14

1. Fëmijët nuk duhet ta ndërpresin shokun kur flet.
2. Fëmijët nuk duhet të gjykojnë mendimin dhe sjelljen e njëritjetrit
3. Fëmijët duhet të dëgjojnë dhe respektojnë fjalën e prindërve dhe kujdestarëve.
4. Fëmijët duhet t'i mësojnë dhe zbatojnë të drejtat sipas zotësive që kanë.
5. Fëmijët duhet të respektojnë fenë dhe besimet e të tjerëve.
6. Fëmijët duhet t'u binden ligjit, edhe kur ai ndalon të drejtat.





Të krijojmë një klub mjedisi dhe të demonstrojmë që të mbajmë më pastër qytetin.

Kjo është ide shumë e mirë. Tani që na njoftuat, edhe ne do t'ju ndihmojmë.

Xhaxhi polici, ne duam të dalim në shesh dhe të ftojme të gjithë qytetarët që ta mbajnë më pastër qytetin.

## E drejta e grumbullimit

1. Fëmijët kanë të drejtë të mblidhen në grupe dhe shoqata (qeveria e nxënësve, ambientalistët\*, grupi i letrave). Fëmijët kanë të drejtë të manifestojnë\*\* së bashku në rrugë, duke kërkuar diçka.
2. Fëmijët kanë të drejtë të mblidhen ose të manifestojnë, derisa nuk shkelen të drejtat e të tjerëve.



\* Ambientalistët - Grupi i mjedisit.  
 \*\* Manifestojnë - Një grup njerëzish që dalin në rrugë me tabela për një qëllim të caktuar. Këta njerëz u kërkojnë diçka institucioneve të ndryshme.



Elisa Kotherja

## Detyrat e Nenit 15

1. Fëmijët duhet të manifestojnë në mënyrë paqësore.
2. Fëmijët nuk duhet të prishin qetësinë e të tjerëve.
3. Fëmijët që mbledhen apo që manifestojnë, nuk duhet të përdorin fjalë fyese, armë apo të godasin.
4. Fëmijët që bëjnë pjesë në këto grupe, nuk duhet të shkelin të drejtat e të tjerëve.





Një detyrë për mua është një vend ku  
një person mund të shkruajë gjërat e  
jetës personale. Mësa më shumë të përkrah  
heq që prindërit e mi ta lexojnë detyrën  
unë tim përse unë s'kam mund të  
kisha shkruar gjëra që s'ishte në  
mund t'ia kishim flenë nëlonjherë.

Andrea Shaban, nxënëse e kl. V, shkollë  
"Abdullin Gërvani" Tironi

Unë nuk kam detyrë, do të doja që të kisha  
të gjithë familjen për këtë kam menduar shpesh  
për këmbë. Është detyrë shkruar gjërat personale  
male që he detyrë tim nuk do të dëshiroja  
gjëra të ma lexojnë asnjë prindës, motër e për  
dij. Është një detyrë që do të më ndo-  
edhe unë do ta kam një detyrë. Për mua  
detyrë është një detyrë me vlerë.

Enri Arjola Lusha.  
SHKOLLA: "Ruzha" Drishti  
KLASA: IV b

### E drejta për të pasur një jetë private

1. Fëmija ka të drejtë të ketë jetë private\*. Këtë të drejtë të fëmijës nuk duhet t'ia shkelë as shteti, as njeri tjetër. Gjithashtu, fëmija ka të drejtë të ketë rëndësinë e tij në shoqëri
2. Këto të drejta mbrohen me ligj.

\* Jetë private - Sekretet, shtëpia, letrat, detyrat, bisedat telefonike.



Unë kam marrë letra nga shokët që ndodhen jashtë shtetit.  
T gjithmonë kur vini letra në emrin tim unë i gjy  
ata të mbyllura. Prindërit s'mi kanë dhënë letra të  
hapura asnjëherë.

Këtu dja gj' unë ndihem i qersuar.

Edison Malina, klasa e VI<sup>o</sup> SHKOLLA "7 MARS" I

A marr letra nga miqtë e tu?  
Sigurisht unë marr letra nga  
shoqet e mia, që kam jashtë shtetit.  
Ne emrin tim vijne letra, dhe në  
shtëpi nuk mi hap askush. Dhe kë-  
shtu unë ndihem e qetë për ato çime  
shprehje.

Eldo Bili  
Kl. 6<sup>o</sup>  
SHKOLLA "7 MARS" I

## Detyrat e Nenit 16

1. Asnjë fëmijë nuk duhet të ndërhyjë në gjërat sekrete të tjetrit.
2. Asnjë fëmijë nuk duhet të përgjojë nëpërmjet derës ose telefonit.
3. Asnjë fëmijë nuk duhet të flasë keq për të tjerët në shoqëri.
4. Asnjë fëmijë nuk duhet të lexojë letrat dhe ditaret e të tjerëve.
5. Asnjë fëmijë nuk duhet të kontrollojë gjërat e një fëmije tjetër pa lejen e tij.
6. Asnjë fëmijë nuk duhet të thotë thashetheme.



## E drejta për të pasur informacionin e nevojshëm

Shteti duhet të bëjë gjithçka që fëmija të marrë njohuri nga mjetet e informacionit (radioja, televizioni, gazeta, revista etj). Këto njohuri mund të jenë për vendin e tyre dhe vendet e tjera. Këto njohuri ndihmojnë në zhvillimin trupor, mendor dhe shpirtëror të fëmijës. Për këtë qëllim këto shtete:

- (a) Nxisin mjetet e informacionit të shpërndajnë lajme dhe njohuri shoqërore dhe kulturore, që u shërbejnë fëmijëve.
- (b) Shtetet mund të punojnë së bashku duke dhënë e duke marrë njohuri që i ndihmojnë fëmijët.
- (c) Shteti duhet të botojë dhe shpërndajë libra për fëmijë.





(d) Shteti duhet t'i shtyjë mjetet e informacionit ( radio, televizion, gazeta, revista etj) që të bëjnë emisione dhe shkrime për fëmijët e pakicave dhe këto emisione dhe shkrime duhet të jenë në gjuhën e pakicave.

(e) Këto shtete mbrojnë fëmijët nga lajmet, pamjet, filmat dhe historitë që u bëjnë keq atyre.



## Detyrat e Nenit 17

1. Fëmijët duhet të marrin njohuri nga mjetet e informacionit.
2. Fëmijët duhet të lexojnë librat që janë për ta dhe t'i ruajnë ata.
3. Fëmijët duhet të zbatojnë njohuritë e marra nga librat.
4. Fëmijët duhet t'u shpërndajnë shokëve librat dhe njohuritë që marrin nga to.
5. Asnjë fëmijë nuk duhet të pengojë një fëmijë tjetër të marrë njohuri në gjuhën e tij.
6. Fëmijët nuk duhet të shohin vetë dhe të detyrojnë fëmijët e tjerë të shohin lajme, filma, pamje dhe histori që u bëjnë keq fëmijëve.

Blerina Maloku



## Neni 18



## Përgjegjësitë prindërore

1. Të dy prindërit kanë njëloj për detyrë të rrisin dhe të edukojnë fëmijën. Këtë detyrë e kanë edhe njerëzit që me ligj kujdesen për fëmijën. Kjo bëhet për interesin më të lartë të fëmijës.
2. Kur prindërit nuk kujdesen dot për fëmijën, shteti i ndihmon prindërit dhe fëmijët.
3. Shteti ndërton institucione (çerdhe, kopshte) që kujdesen për fëmijët. Fëmija ka të drejtë të fitojë nga këto institucione. Kjo bëhet kur i ka prindërit në punë dhe nuk mund të kujdesen për të.



### Mbrojtja nga keqtrajtimi dhe mospërfillja

1. Fëmija ka të drejtë të mbrohet nga çdo lloj keqtrajtimi. Keqtrajtimet mund të jenë fyerja, rrahja shkelja e të drejtave, braktisja, shfrytëzimet, keqtrajtimi seksual\* etj. Ai mbrohet nga shteti edhe kur është në kujdesin e prindërve dhe të njerëzve që me ligj kujdesen për të.
2. Shteti duhet të ndihmojë fëmijët e trajtuar keq. Ai duhet të gjejë njeriun që e ka trajtuar keq fëmijën dhe të sigurohet që nuk do ta bëjë më këtë gjë. Nëse është e nevojshme, ndërhyjnë gjykatat.

\* Keqtrajtim seksual - Kur një i rritur bën diçka të turpshme me një fëmijë, kur një i rritur tregon pjesë të trupit që nuk duhet të tregohen, kur të rriturit bëjnë me fëmijët gjëra që i bëjnë me njëri-tjetrin (pyesni prindërit për më shumë hollësi)


### Detyrat e Nenit 19

1. Fëmijët duhet të tregojnë, kur të tjerët sillen keq me ta.
2. Fëmija duhet t'i kërkojë ndihmë shtetit, kur atë e kanë lënë prindërit dhe nuk kujdesen për të.
3. Fëmijët nuk duhet të bëjnë gjëra të turpshme.
4. Fëmijët nuk duhet të fyejnë apo të godasin fëmijët e tjerë.




## Neni 20

Nuk keni treguar kujdesin e duhur për fëmijën tuaj. Për këtë arsye, shteti do e marrë nën kujdesje. Kjo bëhet "Për interesin më të lartë të fëmijës.



## Mbrojtja e fëmijës pa familje

Shteti mund t'i heqë fëmijën prindërve për një kohë të caktuar ose përgjithmonë. Kjo bëhet për interesin më të lartë të fëmijës. Shteti e cakton fëmijën të jetojë në një familje tjetër ose në jetimore. Kjo bëhet sipas ligjeve. Fëmija edhe mund të birësohet nga një familje tjetër.



Artemisa Cane

## Detyrat e Nenit 20

1. Fëmija duhet të sillet mirë me familjen që e ka birësuar.
2. Fëmija duhet të zbatojë rregullat e vendit ku kujdesen për të.
3. Fëmijët nuk duhet t'ua përmendin fëmijëve të adoptuar këtë gjë.




## Birësimi

Çdo fëmije që nuk ka kujdesin e prindërve, ka të drejtë të birësohet\*. Kjo bëhet për interesin më të lartë të tij. Birësimi bëhet nga ato shtete që e pranojnë dhe e lejojnë atë.

(a) Birësimi i fëmijës duhet të bëhet vetëm nga shteti. Kjo bëhet sipas ligjit. Fëmija mund të birësohet vetëm atëherë kur prindërit e vërtetë dhe ata që e birësojnë janë të një mendimi. Në këto raste prindërit, fëmija, njerëzit që me ligj kujdesen për fëmijën dhe të afërmit duhet të japin pëlqimin e tyre.

(b) Në qoftë se fëmija nuk mund të birësohet nga një familje në vendin e tij, ai mund të birësohet në një vend tjetër. Kjo bëhet për të mirën e fëmijës.





- (a) Kur një fëmijë birësohet në një vend tjetër, ai duhet të ketë të njëjtat të drejta si në vendin e tij.
- (b) Kur fëmija birësohet brenda dhe jashtë shtetit, askush nuk duhet të fitojë para në mënyrë të paligjshme nga kjo gjë.
- (c) Shtetet merren vesh që birësimi i fëmijës në një vend tjetër të bëhet vetëm nga shteti. Për këtë gjë bëhen marrëveshje mes dy a më shumë shteteve.

\* Birësimi - Kur merr një fëmijë dhe e rrit si birin tënd; dhënia e një fëmije një prindi tjetër por me ligj; birësohet një fëmijë që nuk i ka të dy prindërit ose që nuk kujdesen dot për të. Një fëmijë që birësohet nuk quhet më jetim.

## Detyrat e Nenit 21


1. Fëmijët duhet të pranojnë kur i birësojnë.
2. Fëmijët duhet të sillen mirë me fëmijët e birësuar.
3. Fëmijët duhet të sillen mirë me prindërit që i kanë birësuar.
4. Në qoftë se kanë mundësi, fëmijët duhet të shprehin mendimet e tyre kur diskutohet për birësimin e tyre.
5. Fëmijët duhet të tregojnë, kur e dinë se nga birësimi i tyre fitohen para në mënyrë të paligjshme.
6. Fëmijët duhet të tregojnë, kur familja që i ka birësuar sillet keq me ta.



## Të drejtat e fëmijëve refugjatë

1. Çdo fëmijë, që largohet nga vendi i tij sepse i rrezikohet jeta, ka të drejtë të jetojë në një vend të sigurt për një kohë të caktuar. Ky fëmijë quhet refugjat. Ai mund të jetë me prindërit apo vetëm. Vendi që i mirëpret duhet t'i mbrojë dhe t'i ndihmojë fëmijët refugjatë.

2. Për të ndihmuar fëmijët refugjatë, një vend punon bashkë me vendet e tjera dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Shteti kërkon familjen dhe të afërmit e një fëmije, që ai të bashkohet me to. Në qoftë se fëmija mbetet vetëm (nuk gjendet familja ose të afërmit), ai mbrohet si një fëmijë jetim, sipas ligjit të atij shteti.



\* Refugjat - Është ai fëmijë që largohet pa dëshirë nga vendi i tij, sepse rrezikohet jeta. Jeta e një fëmije refugjat mund të rrezikohet kur ai kërcënohet ngaqë është i një kombësie tjetër, feje tjetër, bindjeje politike tjetër dhe flet një gjuhë tjetër.

### *Refugjatët*

*Fëmijë që qajnë  
Ploq të raskapitur  
Nëna me fëmijë në gji  
Bredhin rrugëve të uritur*

*I shpëtuan vdekjes  
Lufta është padrojtësi  
Fëmijët nëpër dimër  
Duan ngrohtësi*

*Na gjeni një shtëpi  
Kjo botë e egër na vret  
Se fëmijët duan liri  
Paqe lumturi dhe shëndet*

*Artemisa Cane*

## **Detyrat e Nenit 22**

1. Fëmijët duhet të sillen mirë me fëmijët e tjerë refugjatë.
2. Fëmijët duhet t'i ndihmojnë fëmijët refugjatë.
3. Fëmijët refugjatë duhet t'i binden ligjeve të shtetit që i mirëpret.
4. Fëmijët duhet t'i këshillojnë njerëzit që sillen keq me fëmijët refugjatë.






## Neni 23



## Të drejtat e fëmijëve me paaftësi mendore dhe fizike

1. Fëmijët që kanë paaftësi mendore dhe fizike kanë të drejtë të jetojnë si të gjithë fëmijët e tjerë. Ata kanë të drejtë të jenë të lirë të mos fyhen e keqtrajtohen nga askush. Gjithashtu, ata kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme.
2. Çdo fëmijë me paaftësi mendore dhe fizike ka të drejtë të ketë kujdes të veçantë. Shteti duhet t'i ndihmojë këta fëmijë me aq sa ka mundësi. Ndihma mund të jenë: mjekimi, ushqimi i mirë, paratë etj.
3. Këta fëmijë kanë të drejtë të marrin ndihma falas (pa paguar) nga shteti. Kjo bëhet sa herë që është e mundur. Ndihmat jepen që fëmija të shkollohet, të ketë kujdesin e mjekëve, të mësojë një profesion\*\* dhe të ndihmohet që të ketë ato aftësi që ka humbur. Ai ka të drejtë të luajë, të marrë pjesë si të gjithë fëmijët e tjerë në aktivitetet që bëhen në shkollë, lagje, qytet etj.



4. Shtetet punojnë bashkë që të ndihmojnë sa më mirë fëmijët. Gjithashtu, ata japin informacione të ndryshme për këtë gjë. Një ndihmë e veçantë i jepet vendeve të varfëra.

\* Fëmijët me paaftësi mendore dhe fizike -Quhet ai fëmijë që nuk bën dot veprime të caktuara dhe jeta e tij varet nga diçka e caktuar, si ilaçi etj. Fëmijë të tillë janë fëmijët e verbër, shurdhëmecë, të paralizuar; të gjymtuar, të sëmurë nga epilepsia, diabeti, poliomieliti, skizofrenia etj.  
\*\*\*Profesion -Puna që bën një njeri; puna që do të bëjë më vonë.



Blerina Maloku  
Julika Çota

## Detyrat e Nenit 23

1. Fëmijët duhet të sillen mirë me fëmijët me paaftësi mendore dhe fizike.
2. Fëmijët duhet t'i mbrojnë këta fëmijë, kur të tjerët sillen keq me ta.
3. Fëmijët duhet të luajnë me këta fëmijë dhe kurrë nuk duhet të tallen me ta.
4. Fëmijët duhet të organizojnë aktivitete për fëmijët me paaftësi mendore dhe fizike.





## Neni 24



## E drejta për kujdes dhe shërbime shëndetësore

1. Fëmija ka të drejtë të ketë një shëndet sa më të mirë. Ai duhet të fitojë nga ndihmat që i jepen për shërimin e tij. Fëmijës nuk duhet t'i mohohet kjo e drejtë.

(a) Shteti duhet të kujdeset që të zbatohet kjo e drejtë e fëmijëve.

(b) Shteti duhet të bëjë çdo gjë që mundet që të ketë sa më pak vdekje të foshnjëve dhe fëmijëve.

(c) Gjithashtu, shteti u siguron fëmijëve ndihmën e nevojshme të mjekëve dhe kujdesin për shëndetin e tyre.

(d) Shteti ndihmon për të luftuar sëmundjet dhe që fëmijët të ushqehen mirë, duke përdorur mënyra të thjeshta, që mund të bëhen nga të gjithë. Këto mënyra mund të jenë: duke pirë ujë të pastër, duke njohur rreziqet që sjell mjedisi i papastër, duke kontrolluar që ushqimet t'i bëjnë mirë fëmijës.





(e) Shteti duhet t'u sigurojë nënave një shëndet të mirë para dhe pas lindjes.

2. Që të gjithë, në veçanti prindërit dhe fëmijët, duhet të marrin të dhëna, të edukohen dhe të ndihmohen, që të përdorin ushqime sa më të mira për shëndetin e fëmijës. Është e rëndësishme që foshnjat të ushqehen me qumështin e nënës dhe të jetojnë në një ambient të pastër. Gjithashtu, prindërit marrin njohuri se si një fëmijë mund të vdesë pa dashje.

3. Ka disa zakone që i bëjnë keq fëmijës (si në Shqipëri, ku i lidhin foshnjat në djep për një kohë të gjatë).

4. Për të respektuar këtë të drejtë të fëmijës shtetet punojnë me njëri-tjetrin. Shtetet e nxisin këtë bashkëpunim. Një ndihmë e veçantë i jepet vendeve të varfëra.



Soela Kotherja



## Detyrat e Nenit 24

1. Fëmijët duhet të shkojnë te mjeku sa herë është e nevojshme.
2. Fëmijët duhet të kujdesen për mjedisin ku jetojnë.

## Neni 25



*I dashur ditari,  
Pol unë kam mësuar një fjalë të re. Po unë jam rilur dhe ndihmoj lelal dhe shashal  
mjekë, që vijnë në Phtëpinë tonë të famijës. Fjala e re që kam mësuar është  
“Stelostopi”. Ai na viziton dhe na gëdulis. Ne duhet të marrim frymë dhe të  
kollitemi dhe ai menjëherë na tregon po që se jemi sëmurë. Do thuash li, ku i mësova  
unë gjithë këto gjëra? Në Phtëpinë time të famijës, sot erdhën prap ato lelal dhe  
shashal mjekë, që na shikojnë a jemi sëmurë që nga viti i kaluar apo jo. Një nga  
ato lelal më tha ta ndihmoja dhe ishte shumë qejf. Veç të shikoje ata shokët edhe  
shoqet e mi të Phtëpisë. Edhe kishin frikë kur shikonin gjithë ato vegla që do të na  
vizitonin ne, dhe me zi e mbanin të qeshurën nga kalamajtë e vegjël. Kalamajtë e  
vegjël gëdulisnin nga stelostopi. Kështu që na shoi gjithë dita duke qeshur.  
Mjekët ishin po ata që na vizituan edhe para një viti ljetër. Ata janë gjithmonë  
shumë të mirë me ne. Ne kemi një karton, “kartelë” më duket se quhet, ku mjekët na  
shkruajnë se si është shëndeli ynë. Për vit ata shkruajnë gjëra të tjera aty. Një nga  
ato lelal është shumë e lezetshme dhe asaj i pëlqen të luajë me ne. Ajo na thotë që  
të hapim gojën, e të bëjmë “a a a” si në opera”. Kur ata të vijnë prap vitin ljetër,  
unë do t’i bëjë një dhuratë asaj: do t’i vizitoj Phtëpinë tonë të famijës, që ajo të mos  
na harrojë kurrë. Me zi po pres ditën kur ajo të vijë prap.*

## E drejta për kontroll periodik të vendosjes nën përkujdesje

Ka disa fëmijë që janë nën mbrojtjen dhe kujdesin e veçantë të shtetit. Këta fëmijë mund të jenë: jetimë, refugjatë, me paaftësi mendore dhe fizike, fëmijët që janë në burg etj. Këta fëmijë kanë të drejtë të kenë kujdesin e rregullt nga mjekët.

52

Konventa për  
të Drejtat e  
Fëmijëve

## Detyrat e Nenit 25

1. Fëmijët nën mbrojtjen e shtetit duhet të pranojnë ndihmën që u jepet.
2. Fëmijët nuk duhet të tallen me fëmijët që janë nën kujdesin e shtetit.





## E drejta për përkrahje shoqërore

1. Çdo fëmijë ka të drejtë të marrë nga shteti përkrahje shoqërore\*. Shteti bën gjithçka që kjo e drejtë e fëmijës të zbatohet. Kjo bëhet sipas ligjeve të shtetit ku jeton.
2. Çdo fëmijë ka të drejtë të marrë ndihmë kur ka nevojë. Kërkesën për ndihmë e bën fëmija, të afërmit ose njerëzit që me ligj kujdesen për të. Fëmija duhet të ndihmohet nga shteti, kur familja nuk ka para dhe mundësi. Kjo bëhet që fëmija të rritet sa më mirë. Kjo ndihmë jepet sipas të ardhurave dhe kushteve në të cilat jeton fëmija.

## Detyrat e Nenit 26

1. Fëmija nuk duhet t'i prishë kot paratë që i jepen.

Lusi ka një vëll të vogël, që mami ia lindi muajt e kaluar. Lusi është shumë e lumtur për atë buçkon e vogël sa pëllëmba e saj. Lusi është shumë e trishtuar për vëllain e vogël. Mami i ankohet se megjë ajo nuk punon tani që rri në shtëpi me vëllain, nuk kanë lekë për të paguar, qeranë, për të blerë libra për Lusin dhe roba për vëllain e vogël. Vetëm tani Lusi ka kuptuar që kur prindërit kanë fëmijë, ata kanë nevojë për më shumë para. Ata duhet të blejnë ushqim, libra për shkollën e Lusi, ilaçe, etj. Ajo ka kuptuar që prindërit e saj kanë nevojë për ndihmë në lekë, por puna e mamit nuk e paguan më. Askush nuk kujdeset për familjen e Lusi. Lusi do të donte që të kënaqej me vëllain, por ja që ka filluar të mendohet për gjithë këto gjëra. Edhe babi është shumë i shqetësuar dhe i mërzitur. Puna e tij, është mbyllur dhe ai ka mbetur pa punë. Askush nuk e ndihmon atë për sa kohë është i papunë. Por Lusi dëgjoj në shkollë fjalën "Pshel", po Lusi nuk e kapton. Ajo nuk e di çfarë mund të bëjë shteti për familjen e vet. Ajo di vetëm se ajo e do shumë vëllain e vogël, dhe trembet nga fytyra e shqetësuar e prindërve. Lusi di vetëm se dikush duhet t'i ndihmojë përdërisa mami është me lejen e lindjes dhe babi nuk ka punë. Lusi e di që ajo ka nevojë të vishet dhe të ketë libra dhe lodra. Lusi di vetëm se ajo është e lumtur për atë buçkon e vogël sa pëllëmba e saj vetë. Lusi di që është shumë e trishtuar, dhe ajo e di që nuk e zgjidh dot këtë. Aq shumë e trishtuar është Lusi, sa ndoshta do të donte t'i përgjerohej atij "Pshel" që ia ndihmonte, po nuk e dinte ku e kishte shtëpinë.


\*Përkrahje shoqërore -Ndihmë që shteti i jep të gjithë fëmijëve për t'u rritur sa më mirë, veçanërisht fëmijëve që jetojnë në familje që s'kanë para dhe mundësi që fëmija të rritet sa më mirë. Ndihmat mund të jenë në para, ushqime etj.





## E drejta për një nivel jetese të përshtatshëm

1. Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë të gjitha kushtet e nevojshme për të jetuar. Shteti bën gjithçka që mundet që fëmija të ketë një rritje të mirë të trupit, të mendjes, rritje shpirtërore<sup>\*\*</sup> etj
2. Prindi<sup>\*\*\*</sup>, prindërit ose njerëzit që me ligj kujdesen për fëmijën kanë për detyrë t'i sigurojnë fëmijës kushtet e nevojshme për të jetuar sa më mirë. Kjo bëhet sipas mundësive që ata kanë.
3. Shteti duhet të bëjë gjithçka që mundet për të ndihmuar prindërit dhe njerëzit e tjerë që me ligj kujdesen për fëmijën, që të zbatohet kjo e drejtë e fëmijës. Shteti duhet të ndihmojë me para, ushqime, veshje dhe një vend ku të jetojë fëmija, sipas mundësive që ka shteti.
4. Fëmija ka të drejtë të marrë pension ushqimor<sup>\*\*\*\*</sup> edhe kur njeriu që jep pensionin ushqimor jeton jashtë vendit. Për këtë gjë shtetet punojnë së bashku.



\* Rritje e mirë e mendjes - Të bëhet më i ditur, më i zgjuar.

\*\* Rritje shpirtërore - Rritja e shijave, dëshirave dhe ndjenjave, besimit fetar etj.

\*\*\* Kur ndodh që femija jeton vetëm me një prind.

\*\*\*\* Pension ushqimor - Ndhimë që i jepet fëmijës në para për të plotësuar kushtet e nevojshme që i duhen për të jetuar. Këtë pension e jep prindi tjetër ose shteti, ose një njeri që i siguron fëmijës para për të jetuar.

## Detyrat e Nenit 27

1. Fëmijët duhet të kërkojnë të kenë të gjitha kushtet e nevojshme për të jetuar.
2. Fëmijët nuk duhet të kërkojnë më shumë se mundësitë që kanë prindërit.
3. Fëmijët duhet të pranojnë ndihmën që u jepet për të mirën e tyre.
4. Fëmijët duhet ta përdorin mirë pensionin ushqimor që u jepet.



Nëse bota do të kishte një fshat më ekzaktesisht 100 banorë, banorët do të ishin si më poshtë:

**Do të kishte:**

57 njerëz nga Azia

21 njerëz nga Europa

14 nga kontinenti i Amerikës  
(Amerika Jugore dhe Veriore)

8 njerëz nga Afrika

1 (po, vetëm një) do të kishte studiuar  
më shumë se shkolla fillore.

Nëse keni ushqim në frigorifer, rroba në dollap, tavan mbi kokë dhe një vend për të fjetur atëherë jeni më i pasur se 75% e të gjithë njerëzve në botë.

Nëse keni para në bankë apo në xhep, dhe para për të jetuar diku, atëherë bëni pjesë në 8% të njerëzve më të pasur në botë.

Nëse mund ta lexoni këtë libër atëherë jeni më të ditur se 2 miliardë (2.000.000.000) njerëz në botë ata nuk mund të lexojnë.

Nëse e shohim botën nga një këndvështrim i tillë, nevoja për edukim bëhet shumë e qartë për secilin nga ne.

## E drejta për arsim

1 Çdo fëmijë ka të drejtë të shkojë në shkollë dhe të edukohet. Të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësi të barabarta për t'u shkolluar. Kjo e drejtë bëhet hap pas hapi<sup>1</sup>. Për këtë gjë shteti:

(a) E bën shkollën 8-vjeçare të detyrueshme dhe falas për të gjithë fëmijët.

(b) Shteti duhet të hapë shkolla të mesme të përgjithshme dhe profesionale<sup>2</sup>. Në këto shkolla mund të shkojë çdo fëmijë. Në qoftë se një fëmijë është jetim ose i varfër, nuk ka mundësi të vazhdojë shkollën, shteti duhet të paguajë shkollën e tij.

(c) Çdo fëmijë ka të drejtë të ndjekë shkollën e lartë sipas aftësive. Shteti, kur është e nevojshme, ndihmon fëmijët të ndjekin shkollën.

(d) Çdo fëmijë ka të drejtë të marrë të dhëna për shkollat e mesme të përgjithshme ose profesionale.

(e) Shteti duhet të bëjë gjithçka që mundet që të nxisë fëmijët të shkojnë në shkollë rregullisht. Mund të ndodhë që fëmija të lërë shkollën. Shteti mundohet që të ketë sa më pak fëmijë që lënë shkollën.

2. Shteti kujdeset që rregullat e shkollës të mos shkelin të drejtat e fëmijës.






3. Shtetet punojnë që të ketë sa më pak fëmijë që nuk dinë të shkruajnë, lexojnë dhe që nuk kanë njohuritë e duhura<sup>\*\*\*</sup>. Gjithashtu, shtetet ndihmojnë në përmirësimin e mësimin nëpër shkolla. Një ndihmë e veçantë u jepet vendeve të varfëra.

\* Hap pas hapi - Në fillim kopshti, pastaj shkolla fillore, 8-vjeçare, e mesme, e lartë.

\*\* Shkollë profesionale - Shkollë e mesme ku mëson një profesion, ku marr një profesion, mëson një punë për të ardhmen.

\*\*\* 100 milionë fëmijë në botë nuk kanë arsimin bazë. 2/3 e këtyre janë vajza. Grupet e fëmijëve që janë më në rrezik për të ndjekur shkollën janë: vajzat, minoritarët, fëmijët nga zonat fshatare, fëmijët me pasftesë dhe fëmijët që janë në burg.



Emi Xhani

## Detyrat e Nenit 28

1. Fëmijët nuk duhet t'i përdorin qeq paratë që u jepen nga shteti për të vazhduar shkollën.
2. Fëmijët duhet të shkojnë rregullisht në shkollë.
3. Fëmijët nuk duhet të shkelin rregullat e shkollës.
4. Fëmijët duhet të bëjnë detyrat e shkollës.
5. Fëmijët duhet të respektojnë mësuesit.



## Neni 29

Unë shkoj në shkollë sepse dua të bëhem një qytetar i mirë që t'i shërbej vendit tim.



Unë shkoj në shkollë muzike, dua që të bëhem një violinist i madh, ashtu si Paganini.

Unë shkoj në shkollë që të mësoj sa më shumë për vende të tjera dhe si të shpëtoj ambientin.



Fëmijët nuk duhet të harrojnë se ndërsa mësojnë gjithçka duhet të respektojnë të drejtat e gjithë fëmijëve të tjerë.



Unë shkoj në shkollë që të mësoj sa më shumë për kulturën dhe historinë, dua të bëhem historiane. Shkolla ime është private, por ne mësojmë ashtu si ju.



## Qëllimet e arsimit

1. Fëmija ka të drejtë të shkojë në shkollë për këto qëllime:

- (a) Të rrisë potencialin e plotë të personalitetit, talentin dhe aftësinë e tij.
- (b) Të respektojë të drejtat dhe liritë e njeriut, të shkruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>.
- (c) Të respektojë edhe më shumë prindërit.
- (d) Të respektojë gjuhën, kulturën, traditat, fenë, monumentet e kulturës, artin, letërsinë e vendit. Ai duhet të respektojë traditat dhe zakonet e vendit ku jeton dhe të vendeve të tjera.
- (e) Të mësojë që ka detyra në jetë dhe se si



duhet t'i zbatojë ato. Të mësojë të jetojë në paqe dhe të respektojë shokun. Të mësojë që të gjithë njerëzit duhet të jetojnë të barabartë.

(f) Fëmija në shkollë mëson të dojë natyrën dhe të kujdeset për të.

2. Ato që u thanë më sipër për shkollën, nuk duhet të bëhen pengesë për hapjen e shkollave private<sup>\*\*\*</sup>. Rregullat e këtyre shkollave nuk duhet të shkelin të drejtat e fëmijëve dhe duhet të respektojnë rregullat që vendos shteti.

<sup>\*\*</sup>Potenciali i personalitetit - Mundësia që ka dikush për të bërë diçka nËrËshtje nga të tjerët, t'u tregosh të tjerëve gjithë këtë fuqi. Potencial do të thotë fuqi për të bërë diçka.

<sup>\*\*\*</sup>Karta e Kombeve të Bashkuara - Një dokument ku thuhet se ç'është OKB-ja, me ç'marrim ajo, detyrat e saj, rregullat që vendet pranojnë për të punuar me njëri-tjetrin, rregullat që duhet të pranojnë për të hyrë në OKB.

<sup>\*\*\*\*</sup>Shkolla private - Shkolla që nuk drejtohen nga shteti dhe që janë me pagesë.

## Detyrat e Nënit 29

1. Çdo fëmijë duhet të kujdeset për mjedisin ku jeton.
2. Çdo fëmijë duhet të jetë tolerant.
3. Çdo fëmijë duhet të ndjekë shkollën sipas ligjeve të shtetit ku jeton.
4. Fëmijët duhet të respektojnë traditat e të gjitha vendeve.




## Neni 30



### Të drejtat e fëmijëve të pakicave etnikë dhe të popullsisë autoktone

Çdo fëmijë që bën pjesë në një pakicë etnike<sup>\*</sup>, fetare<sup>\*\*</sup>, ose gjuhësore<sup>\*\*\*</sup> ka të drejta të barabarta me fëmijët e tjerë. Ai ka të drejtë të mësojë dhe të flasë gjuhën e tij. Gjithashtu, ka të drejtë të tregojë fenë dhe të ndjekë traditat dhe zakonet e pakicës ku bën pjesë. Këto të drejta i kanë edhe fëmijët me origjinë outoktone<sup>\*\*\*\*</sup>.



**\*Palcë etnike** - Njerëz që flasin një gjuhë të ndryshme nga pjesa më e madhe e popullsisë së një vendi, kanë zakone, tradita dhe kulturë të ndryshme dhe janë më pak se gjysma e popullsisë së një vendi.

**\*\*Palcë gjuhësore** - Njerëz që flasin një gjuhë të ndryshme nga pjesa më e madhe e popullsisë së një vendi dhe janë më pak se gjysma e popullsisë së një vendi.

**\*\*\*Palcë feqare** - Njerëz që kanë një fe tjetër nga pjesa më e madhe e popullsisë së një vendi.

**\*\*\*\*Originë autoktone** - Janë njerëz që banojnë në atë vend ku kanë jetuar paraardhësit e tyre që në kohët më të lashta, p.sh., Indianët e Amerikës etj.

## Detyrat e Nenit 30

1. Fëmijët duhet të sillen mirë me fëmijët që kanë originë autoktone.
2. Fëmijët duhet të sillen mirë me çdo fëmijë që ka gjuhë të ndryshme.
3. Fëmijët duhet të sillen mirë me fëmijët që kanë zakone dhe tradita të ndryshme.



## Neni 31



## E drejta për kohë të lirë dhe argëtim

1. Çdo fëmijë ka të drejtë të pushojë, të argëtohet dhe të luajë. Ai ka të drejtë të merret me veprimtari krijuese\*. Gjithashtu, çdo fëmijë është i lirë të marrë pjesë në aktivitete që bëhen në lagje, shkollë, qytet etj. Këto bëhen sipas moshës së fëmijës.

2. Shteti duhet të bëjë gjithçka që të drejtat e thëna më sipër të respektohen. Shteti duhet t'i sigurojë fëmijës mundësi të barabarta dhe të përshtatshme për kohën e lirë dhe për aktivitete të ndryshme.

\*Veprimtari krijuese - janë punë me plastelinë, vizatime, punë dore, gjëra artistike të bëra me mjete të ndryshme nga fëmijet.





## Detyrat e Nenit 3 I

1. Fëmijët duhet të respektojnë rregullat e lojës.
2. Fëmijët nuk duhet të zihen gjatë lojës.
3. Fëmijët që kanë fe të ndryshme duhet të luajnë së bashku.
4. Fëmijët duhet të pranojnë në lojë edhe fëmijët me paaftësi mendore dhe fizike.
5. Fëmijët duhet të luajnë me fëmijët e një race tjetër.
6. Fëmijët nuk duhet të prishin vendet ku luajnë.






## Të drejtat e fëmijëve që punojnë

1. Çdo fëmijë që punon ka të drejtë të fitojë aq para sa meriton. Puna që mund të bëjë fëmija nuk mund të pengojë shkollimin dhe rritjen e tij. Shteti duhet t'i mbrojtë fëmijët nga ata njerëz që duan të fitojnë padrejtësisht nga puna e tyre.
2. Shteti merr vendime të shumta, si: vendime ligjore, vendime për të edukuar fëmijën dhe vendime që fëmija të marrë pjesë në shoqëri. Për këtë gjë shteti:
  - (a) Cakton moshën se kur një fëmijë mund të hyjë në punë.
  - (b) Cakton se sa kohë duhet të punojë një fëmijë. Gjithashtu, përcakton edhe kushtet e punës sipas moshës së fëmijës.
  - (c) I dënon ata që nuk e zbatojnë këtë nen.



Fëmijët nuk  
duhet të punojnë



Blerina Maloku



... lezim banane!

Jerin Sava

## Detyrat e Nenit 32

1. Fëmijët duhet të bëjnë punë që nuk u dëmtojnë shëndetin.
2. Fëmijët nuk duhet të lënë shkollën për të punuar.
3. Fëmijët duhet të sillen mirë me fëmijët që punojnë.
4. Fëmijët duhet punojnë për një kohë të caktuar.
5. Fëmijët duhet t'i përdorin paratë që fitojnë për të mirën e tyre.






## E drejta për të mos përdorur dhe prodhuar drogë

Shteti duhet të bëjë gjithçka që fëmijët të mos përdorin drogë pa lejen e mjekut. Asnjë fëmijë nuk duhet të përdoret për prodhimin dhe shpërndarjen e drogës.



## STOP DROGËS



Emi Xhani

\*Drogë - ilaçe, që kur pihen pa lejen e mjekut, i bëjnë dëm trupit të njeriut. Të rriturit pijnë për qejf, si morfinë, kokainë, heroinë, kafeinë etj.

### Detyrat e Nenit 33

1. Fëmijët nuk duhet të marrin pjesë në prodhimin e drogës.
2. Fëmijët nuk duhet të shpërndajnë drogë.
3. Fëmijët nuk duhet të përdorin drogë.
4. Fëmijët nuk duhet të pijnë ilaçe pa lejen e mjekut dhe prindërve.
5. Fëmijët duhet të tregojnë kur i detyrojnë të shpërndajnë drogë.
6. Fëmijët nuk duhet të nxisin të tjerët për të përdorur drogë




## E drejta për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi seksual

Fëmija ka të drejtë të mbrohet nga shfrytëzimi seksual<sup>16</sup>. Shteti bën gjithçka që të mbrojë fëmijën nga shfrytëzimi seksual. Gjithashtu, ai e mbron fëmijën nga keqtrajtimi seksual. Shteti punon si brenda vendit, ashtu edhe me vendet e tjera për të mos lejuar që të ndodhin këto gjëra.

(a) Shteti dënon të gjithë ata që nxisin dhe detyrojnë fëmijët që të bëjnë gjëra të turpshme dhe që të tregojnë pjesë të trupit që nuk duhet të tregohen.

(b) Fëmijët nuk duhet të përdoren për prostitucion ose për qëllime të tjera seksuale kundër ligjit.





(c) Fëmijët nuk duhet të përdoren për të treguar gjëra të tjera të turpshme përpara njerëzve të tjerë ose përpara kamerave, aparateve fotografike etj.

**Shfrytëzim seksual** -Kur një i rritur bën diçka të turpshme me një fëmijë, kur një i rritur tregon pjesë të trupit që nuk mund të tregohen, kur të rriturit bëjnë me fëmijet gjëra që i bëjnë me njëri-tjetrin për të fituar para (pyesni prindërit për më shumë hollësi).



## Neni 35



## E drejta për të mos u shitur dhe trafikuar

Shteti duhet të bëjë çdo gjë që mundet që fëmijët të mos rrëmbehen, shiten dhe trafikohen. Për këtë gjë shtetet bëjnë çdo gjë që mundin si brenda vëndit, ashtu edhe me vendet e tjera duke bashkëpunuar me ta.

## Detyrat e Nenit 35

1. Fëmijët nuk duhet të sillen keq me fëmijët që punojnë, lypin, shfrytëzohen seksualisht.
2. Fëmijët duhet të ndihmojnë me aq sa kanë mundësi fëmijët e rrëmbyer, të shitur, të trafikuar.



## E drejta për t'u mbrojtur nga çdo formë shfrytëzimi

Fëmijët mund të shfrytëzohen edhe në mënyra të tjera, si, p.sh.: shfrytëzimi i talentit të fëmijës, eksperimentet prej të cilave fitohen para etj. Shtetet duhet t'i mbrojnë fëmijët nga këto shfrytëzime, sepse i bëjnë keq rritjes së tyre.

### Detyrat e Nenit 36

1. Fëmijët duhet të kërkojnë ndihmë, në qoftë se e ndjejnë veten të shfrytëzuar.





## Neni 37



### E drejta për të mos u torturuar dhe mbrojtja e lirisë

(a) Asnjë fëmijë nuk duhet të torturohet\*, të fyer, të dënohet në mënyrë mizore. Fëmija mund të arrestohet, ndalohet ose burgoset vetëm kur nuk ka zgjidhje tjetër. Shteti duhet ta bëjë këtë sipas ligjit dhe për një kohë sa më të shkurtër.

(b) Fëmija duhet të trajtohet sipas nevojave të moshës së tij. Çdo fëmijë që është në burg, nuk duhet të qëndrojë atje me të rriturit. Ai duhet të qëndrojë me ta vetëm nëse është në interesin më të lartë të tij\*\*. Fëmija ka të drejtë të mbajë lidhje me familjen me anë të letrave dhe vizitave. Në raste të veçanta kjo nuk lejohet.

(c) Çdo fëmijë, të cilit i është hequr liria (që është në burg ose shkollë riedukimi), ka



të drejtë të ketë ndihmën e një avokati ose të një institucioni që e mbron me ligj. Ai ka të drejtë të kërkojë që të ndryshohet vendimi i marrë nga gjykata për të . Për të gjitha rastet e thëna më sipër, gjykata duhet të marrë një vendim sa më të shpejtë që të jetë e mundur.

\*Torturë - Quhet çdo veprim që jep dhembje ose vuajtje fizike apo mendore, që i bëhet dikujt nga një autoritet, si polici, mësuesi, shteti etj.  
\*\*Mund të ndodh që fëmija është shumë i vogël ose ka ndonjë sëmundje që kërkon kujdesin e përhershëm të të rriturve.



Julka Cota

## Detyrat e Nenit 37

1. Fëmijët duhet të ndihmojnë fëmijët që torturohen, në qoftë se kanë mundësi.
2. Fëmijët duhet të zbatojnë ligjin.
3. Fëmijët nuk duhet të sillen keq me fëmijët e tjerë, edhe kur detyrohen nga të tjerët.
4. Fëmijët duhet të sillen mirë me fëmijët e dalë nga burgu.





## Neni 38



## Të drejtat e fëmijës në konflikte të armatosura

Në kohë lufte, çdo fëmijë që nuk ka mbushur 15 vjeç nuk duhet të marrë pjesë në luftë. Nga fëmijët 15-18 vjeç që merren në luftë, shteti duhet të marrë ata fëmijë që janë më të mëdhenj. Shteti duhet të mbrojë dhe të kujdeset për fëmijët e dëmtuar nga lufta.

## Detyrat e Nenit 38

1. Fëmijët nuk duhet të luajnë me armët.
2. Fëmijët duhet të qortojnë fëmijët që mbajnë armë.





## E drejta për kujdes për riaftësim

Fëmija mund të jetë viktimë\* e një pakujdesie, e një shfrytëzimi ose e një keqtrajtimi. Ai mund të jetë viktimë edhe e një torture ose e një grindjeje me armë. Shteti duhet të bëjë gjithçka që fëmijët, të cilët janë viktimë e çdo lloj forme, të kthehen si më parë. Gjithashtu, shteti bën gjithçka që këta fëmijë të futen përsëri në shoqëri. Kthimi në shoqëri dhe fitimi i aftësive të humbura duhet të bëhet në një vend që ndihmon rritjen dhe shëndetin e fëmijës.

\*Viktimë - Ai që vritet, plagoset ose pëson pa të drejtë një të keqe të madhe nga dikush.





## Të drejtat e fëmijës në konflikt me ligjin

1. Çdo fëmijë që dyshohet ose mendohet se ka shkelur ligjin, ka të drejtë të ketë kujdes të veçantë. Kjo bëhet që të mos fyhet dhe të rrisë vlerësimin për veten. Kjo bëhet sipas moshës së fëmijës dhe në të mirë të tij, për të hyrë përsëri në shoqëri dhe që të ndihmohet që të ecë përpara. Shteti ka për detyrë t'u mësojë këtyre fëmijë të drejtat dhe liritë kryesore të të tjerëve.

2. Për këtë gjë:

- (a) Asnjë fëmijë nuk duhet të dënohet, në qoftë se në kohën kur ka bërë një veprim, ligji që e ndalon këtë veprim, nuk kishte dalë akoma.
- (b) Fëmija ka të drejtë të quhet i pafajshëm derisa faji të provohet me ligj. Çdo fëmijë ka të drejtë të marrë vesh menjëherë dhe drejtpërdrejt për çfarë akuzohet. Ai ka të drejtë të ndihmohet nga një avokat dhe të ketë çdo ndihmë tjetër të nevojshme për t'u mbrojtur.
- (c) Askush nuk mund ta detyrojë një fëmijë të flasë dhe të pranojë fajin. Dëshmitarët që janë kundër ose në mbrojtje të fëmijës duhet të pyeten njëllë nga anëtarët e gjykatës.
- (d) Fëmija ka të drejtë të ankohet, në qoftë se nuk është dakort me vendimin e gjykatës.





Në këtë rast, ai ka të drejtë të shkojë në një gjykatë më të lartë se ajo e para.

(e) Fëmija ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.

(f) Gjatë gjithë gjyqit fëmijës duhet t'i respektohet jeta private.

3. Për të gjithë fëmijët që dyshohen dhe që akuzohen për shkelje të ligjit, shtetet duhet të bëjnë ligje, gjykata dhe burgje të veçanta, vetëm për ta.

(a) Shteti cakton një moshë kur një fëmijë mund të dalë para gjyqit si fajtor. Poshtë kësaj moshe mendohet se fëmija nuk e kupton se është duke bërë krim. (P.sh.: në Shqipëri moshë është 14 vjeç, në Hong-Kong 7 vjeç etj.)

(b) Shteti duhet të bëjë gjithçka mundet që për këta fëmijë të gjendet një zgjidhje tjetër, që të mos shkojnë në gjyq.

4. Shteti duhet të zgjedhë mënyra të tjera, përveç burgut, për fëmijët e akuzuar ose të dyshuar për shkelje të ligjit, p.sh.: lirim me kusht\*, kujdes nga një familje tjetër, këshillim, arsimim etj.

\*Lirim me kusht - Kur një i burgodur është përmirësuar, pasi ka bërë një pjesë të dënimit, pjesën tjetër e bën jashtë duke u vëzhguar në mënyrë që të mos shkelë më ligjin. N.q.s. e shkel atë, kthehet sërish në burg.





## Neni 41



Duhet të ndyshojmë ligjin sipas Konventës.

Ligji shqiptar në këtë rast i jep më shumë të drejta fëmijës.



## E drejta për respektimin e standardeve më të larta

E gjithë Konventa për të Drejtat e Fëmijës është bërë për interesin më të lartë të fëmijës. Kur ligjet e një shteti i japin më shumë të drejtë fëmijës, atëherë zbatohen ligjet e shtetit dhe jo të Konventës.

Në bazë të Konventës, duhet të mbajmë ligjin shqiptar.





## PJESA E DYTË DHE E TRETË

Në këto pjesë janë detyrimet që ka shteti për zbatimin e të drejtave të fëmijës dhe si kontrollohet ai nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.



## Neni 42

Zbatimi dhe hyrja në fuqi të Konventës për të Drejtat e Fëmijës

Shteti bën gjithçka që të rriturit dhe fëmijët t'i njohin nenet dhe të drejtat e kësaj Konvente. Shteti e bën këtë me anë të mjeteve të përshtatshme, si televizori, radioja, librat etj.

### Detyrat e nenit 42

1. Fëmijët duhet t'ua tregojnë të drejtat e tyre të gjithë njerëzve që kanë mundësi.
2. Fëmijët nuk duhet t'i përdorin keq mjetet që tregojnë të drejtat e fëmijëve.
3. Fëmijët, kur kanë mundësi, duhet të marrin pjesë në të gjitha diskutimet që bëhen për të drejtat e tyre.

## Neni 43

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës pranë kombeve të Bashkuara

1. Organizata e Kombeve të Bashkuara krijon një Komitet që punon për të drejtat e fëmijëve. Ky Komitet përbëhet nga 10 njerëz

që i njohin mirë të drejtat e fëmijëve. Komiteti kontrollon nëse shtetet i kanë zbatuar të gjitha të drejtat e fëmijëve.

2. Njerëzit që do të jenë në komitetet duhet të zgjidhen me votë të fshehtë. Çdo shtet zgjedh nga vendi i tij një njeri për në Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.
3. Zgjedhjet për në Komitetin për të Drejtat e Fëmijës bëhen çdo 2 vjet.
4. Në zgjedhjet për në Komitet duhet të marrin pjesë të paktën 2/3 e shteteve anëtare. Në Komitet hyn ai që merr më shumë se gjysmën e votave.
5. Mund të ndodhë që një pjestar i Komitetit vdes ose nuk mund të marrë pjesë në të. Atëherë shteti zgjedh një kandidat tjetër në vend të tij.
6. Komiteti mbledhet çdo vit.

## Neni 44

Raportimi i shtetit për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës

1. Çdo shtet duhet t'i japë Komitetit një raport\*, ku tregon sa i ka





plotësuar ai të drejtat e fëmijëve në këtë Konventë. Shteti duhet të raportojë dy vjet pasi e ka pranuar Konventën dhe pastaj çdo pesë vjet.

2. Të gjitha raportet duhet të tregojnë vështirësitë për zbatimin e Konventës. Gjithashtu, këto raporte japin të dhëna sa më të mira se si zbatohet Konventa.

3. Shteti i tregon Komitetit raportin e tij të parë. Ai bën çdo gjë që mundet që këto të dhëna të mos përsëriten më në raportet e tjera.

4. Komiteti mund t'i bëjë pyetje shtetit për disa të dhëna që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

5. Shteti shpërndan raportet që ka bërë brenda vendit të tij.

\*Në raport shteti tregon se çfarë ka bërë për zbatimin e Konventës dhe si e ka bërë.

## Neni 45

Puna e Agjencive të Specializuara\* të Kombeve të Bashkuara për zbatimin e Konventës

(a) Komiteti u bën thirrje Agjencive të Specializuara që të ketë një zbatim të plotë të Konventës. Këto organe mund të japin mendime për zbatimin e Konventës në fushat që ato punojnë.


(b) Në qoftë se një shtet ka kërkesa dhe i drejtohet Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ajo i çon kërkesat tek Agjencitë e Specializuara për këtë punë.

(c) Komiteti për të Drejtat e Fëmijës mund të këshillojë Asamblenë e Përgjithshme, t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të bëjë disa studime të rëndësishme që lidhen me të drejtat e fëmijës.

(d) Komiteti për të Drejtat e Fëmijës mund të këshillojë Asamblenë e Përgjithshme, t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të bëjë disa studime të rëndësishme që lidhen me të drejtat e fëmijës.

(e) Komiteti për të Drejtat e Fëmijës mund të japë këshilla për zbatimin e Konventës në një shtet. Këto këshilla i dërgohen këtij shteti dhe Asamblesë së Përgjithshme.

\*Agjenci e Specializuar -Një grup njerzish që punojnë në një fushë të caktuar dhe që e njohin shumë mirë atë fushë.



## Neni 46

Këtë Konventë mund ta pranojnë dhe zbatojnë të gjitha shtetet që duan.

## Neni 47

Kjo Konventë duhet të futet në ligjet e atyre shteteve që e pranojnë atë. Mënyra e pranimi të Konventës ruhen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara\*.

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara - Është njeriu që është në krye të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

## Neni 48

Në këtë Konventë mund të marrin pjesë, plotësisht, të gjitha shtetet. Mënyra e pranimi të Konventës ruhen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

## Neni 49

Kjo Konventë vihet në zbatim 30 ditë pasi është firmosur nga njerëzit që ka caktuar shteti.

## Neni 50

1. Çdo shtet mund të paraqesë një shtesë për Konventën. Ai ia jep këtë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
2. Shtesa që i bëhet një ligji ose një grupi ligjesh zbatohet pasi të jetë miratuar nga 2/3 e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara.
3. Kur një shtesë e Konventës pranohet, këtë duhet ta zbatojnë të gjitha shtetet që e kanë pranuar Konventën.

## Neni 51

1. Çdo shtet mund të bëjë vërejtje për këtë Konventë. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara i merr dhe ua dërgon të gjitha shteteve këto vërejtje.
2. Vërejtjet duhet të jenë në interesin më të lartë të fëmijës dhe në të mirën e tij.



3. Çdo shtet mund t'i heqë vërejtjet e tij duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

### Neni 52

Çdo shtet që e pranon dhe e zbaton këtë Konventë ka të drejtë të mos e ketë Konventën ligj. Këtë e bën duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kjo vihet në zbatim një vit pasi është njoftuar Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

### Neni 53

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ruan këtë Konventë.

### Neni 54

Libri i parë i Konventës është shkruar në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, franceze, ruse. Ky libër ruhet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kjo Konventë është firmosur nga njerëz të caktuar nga shteti.





**Amarda Hoxha**  
14 vjeç  
Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta pa dallim.



**Amarildo Kanellari**  
11 vjeç  
Të gjithë fëmijët që lexojnë këtë libër të mësojnë më shumë për të drejtat e tyre.



**Artemisa Cane**  
10 vjeç  
Shpresojmë që të drejtat e fëmijëve të respektohen.



**Blerina Maloku**  
10 vjeç  
Fëmijët duhet t'i mësojnë të drejtat e tyre dhe t'i respektojnë ato.



**Elban Bardhi**  
11 vjeç  
Lexoni, njihni të drejtat e fëmijëve, por çfarë është më e rëndësishme mbrojeni ato.



**Elisa Kotherja**  
11 vjeç  
Ne punuam shumë për të drejtat tona por kërkojmë që ju të kërkonit që këto të drejta të respektohen.



**Emi Khani**  
11 vjeç  
Të drejtat e fëmijëve duhet të respektohen nga të gjithë.



**Endri Ranzha**  
12 vjeç  
Fëmijët me probleme duhet të sigurohen që të ndihen mirë. Prindërit duhet të ndërgjegjësohen për fëmijët e tyre me paaftësi ose me fëmijë me probleme.



**Enkeleda Cankja**  
11 vjeç  
Ne jemi e ardhmja e Kombit. Ju lutemi bëni të pamundurën për sigurimin e një jete më të mirë.



**Fatjon Çela**  
12 vjeç  
Të drejtat e fëmijve  
janë të rëndësishme.



**Gëzim Saliu**  
13 vjeç  
Mendoj që duhet të dalë  
një gazetë për fëmijët që  
jetojnë në jetimore në  
të gjithë vendin.



**Ingridi Këmbora**  
11 vjeç  
Fëmijët përfaqësojnë të  
ardhmen, prandaj në  
qoftëse respektoni të  
drejtat e tyre do të kemi  
një të ardhme më të  
përsosur.



**Jerin Sava**  
8 vjeç  
Duhet të jemi vetë në  
fëmijët që të vendosim  
për të drejtat tona.



**Julka Çota**  
10 vjeç  
Duke lexuar këtë libër  
mësoni dhe respektoni  
të drejtat tuaja.



**Klaudia Lila**  
11 vjeç  
Fëmijët janë qëniet më  
të sinqerta dhe të  
mrekullueshme në botë,  
prandaj edhe jeta e tyre  
duhet të jetë e përsosur.



**Rudina Hoxha**  
12 vjeç  
Gjatë jetës sime kam  
kuptuar se jeta është  
një mister dhe të të  
gjithë kemi të drejtë  
të jetojmë me  
prindërit tanë.



**Soela Kotherja**  
13 vjeç  
E ardhmja na përket  
neve dhe që ajo të jetë  
sa më e lumtur duhet  
që ne të na respektohen  
të gjitha të drejtat dhe që  
të mos lejojnë asnjë që  
të na i shkelë.



## Konkurs për njohësin më të mirë të të drejtave të fëmijës

- 1) Në cilat prej figurave në krye të librit ndodhin shkelje të të drejtave të fëmijës? Gjeni sa të drejta të fëmijës janë shkelur.
- 2) Cilit nen i përkasin shkeljet e këtyre të drejtave?
- 3) Ne jemi tre shokë që lexuam pjesën e mëposhtme. Njëri prej nesh gjeti një fjali të gabuar, tjetri tre, kurse unë gjeta katër fjali të gabuara. Po ti?

Fëmijët romë duhet të shkojnë në një shkollë më vete. Atje mund të mësojnë më mirë gjuhën dhe traditat e tyre. Kështu respektohen dhe të drejtat e tyre. Ata mund të shoqërohen me shokët e tyre romë. Jo vetëm për romët, shkollat duhet të jenë veç për djemtë, veç për vajzat. Edhe muslimanët me të krishterët duhet të shkojnë në shkolla të veçanta, të mësojnë më shumë për fenë e tyre.

- 4) Korrigjo të gjitha gabimet që gjete në pyetjen 3.
- 5) Si keni vepruar kur keni vënë re shkelje të të drejtave të fëmijës. Bëni një përshkrim sa më të qartë në mënyrë që edhe ne ta kuptojmë sjelljen tuaj.





Jepjani këtë libër për ta lexuar edhe miqve tuaj.  
Mos harroni të shkruani emrin tuaj në listën e fëmijëve që janë njohës të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Emri	Mbiemri	Moshi	Klasa	Shkolla
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·



Emri	Mbiemri	Mosha	Klasa	Shkolla
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·
·	·	·	·	·

# KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS

Për fëmijët, nga fëmijët

